



BASHKIA  
TIRANË

**KESHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 83, datë 26.07. 2017

**PËR**

**“ DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 84, DATË 29.12.2016 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2017-2019 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2017” I NDRYSHUAR”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b) e pika 1/1.3, shkronja (c), nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 54, shkronja (dh) dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja (a) të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrisë të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; udhëzimit plotësues nr.8 datë 13.01.2017 të Ministrisë të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr. 84, datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve dhe shpenzimeve operative brenda Programit të Shërbimeve Publike Vendore, Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik ,Programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, Programit të Strehimit dhe Planifikimit të Territorit si dhe Programit të Kulturës dhe Turizmit për vitin 2017, sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, Programit të Planifikimit, Menaxhimit, Administrimit dhe Programit të Strehimit dhe Planifikimit të Territorit për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda Programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Të miratojë ndryshimin e emërtimeve të objekteve për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të shpenzimeve dhe investimeve brenda Programit të Planifikim, Menaxhim, Administrimit, Programit të Zhvillimit Ekonomik, Programit të Rendit dhe Mbrojtjes Civile dhe Programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 5, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të shpenzimeve dhe investimeve brenda Programit të Kulturës dhe Turizmit për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 6, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të shpenzimeve dhe investimeve brenda Programit të Rinisë dhe Sportit dhe Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik për vitin 2017, sipas pasqyrës nr. 7, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Sistemeve të Informimit dhe IT-së, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Qendra Kulturore “Tirana” dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**